



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova
Komuna e Novobërdës
Opština Novo Brdo - Municipality of Novo Brdo

KUVENDI KOMUNAL-SKUPSTINA OPSTINE- MUNICIPAL ASSEMBLY

Anëtarit të Komitetit për Politikë dhe Financa
Z/znj _____

Në bazë të dispozitave të nenit 52 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale si dhe në bazë të dispozitave të nenit 41 të Statutit të Komunës së Novobërdës.

F T O J

Mbledhjen e parë të Komitetit për Politikë dhe Financa e cila do të mbahet më **22.01.2019** (e martë) duke filluar në ora **10:00**.

R e n d i i d i t ë s

1. Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar e KPF-se;
2. Aprovimi i planit të mbledhjeve të KPF-ës për vitin 2019;
3. Propozim plani i mbledhjeve të Kuvendit për vitin 2019;
4. Raporti i punë se Kryesuesit për punën e Kuvendit-2018;
5. Të ndryshme.


Mbledhja do të mbahet në hapësirat e K.K-së në Novobërdë.

Më:15.01.2019
Në: Novobërdë



Kryesues i Kuvendit
Nebojsa Arsic

Nebojsa Arsic



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosova
Komuna e Novobërdës
Opština Novo Brdo–Municipality of Novo Brdo

KUVENDI KOMUNAL-SKUPSTINA OPSTINE- MUNICIPAL ASSEMBLY

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e dhjetë e Komitetit për Politikë dhe Financa e mbajtur më 17.12.2018, duke filluar në orën 10:00. Në mbledhje kanë marrë pjesë: Anëtarët e KPF-së: Nebojsa Arsic, Milica Jovanovic, Selatin Nuhiu, Mirjana Simijonovic dhe përfaqësuesi i OSBE-se Edmon Hyseni.

Kryesuesi pasi përshëndeti të pranishmit tha: para se të fillojmë me punën e KPF-së dhe rendin e ditës duhet konstatuar korumin prezentë janë katë antarët e KPF-së, Xhejlane Behluli mungon me arsye kemi korumin për punë pas kësaj e hapi mbledhjen me këtë:

R e n d d i t e

1. Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar e KPF-së;
2. Raporti rreth ndarjes së materialit për ngrohje për shkolla dhe ambulanca në teritorin e Novobërdës;
3. Raport për ndarjen e subvencioneve në Drejtorin e Bujqësisë për vitin 2018-të;
4. Të ndryshme.

Kryesuesi i pyeti të pranishmit a pajtohen me këtë rend dite apo keni ndonjë propozim?

Selatin Nuhiu pasi përshëndeti të pranishmit tha: e kamë një propozim që ta bëjmë orarin e mbledhjeve për vitin 2019 të KPF-së, ju faleminderit.

Kryesuesi tha: orarin e mbledhjeve do ta keni në janar pasi që gjithmonë ja kemi bërë kështu, pra do ta keni në mbledhjen e parë të vitit të ardhshëm.

Pasi nuk pati diskutime tjera aprovohet njëzëri rendi i ditës nga antarët prezent.

Pika e parë: Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar e KPF-së;

Kryesuesi e hapi diskutimin për këtë pikë.

Milica Jovanovic pasi përshëndeti të pranishmit tha: unë nuk e kam pranuar procesverbalin.

Kryesuesi tha: procesverbali në gjuhën serbe nuk e keni pranuar për arsye të disa problemeve teknike.

Kryesuesi tha: pasi që se keni procesverbalin në të dy gjuhët po e lëjme që në mbledhjen e ardhshme ti aprovojim të dy procesverbalet.

Pika e dytë: Raporti rreth ndarjes së materialit për ngrohje për shkolla dhe ambulanca në teritorin e Novobërdës;

Kryesuesi tha: ka qenë kërkesë e antarit të Kuvendit Ramush Mehmeti për këtë pikë të rendit të ditës që të na njoftojn rreth lëndëve të ngrohjeve për shkolla dhe ambulanta në teritorin e Komunës së

Novobërdës, kjo pikë për tani është aktuale duke pasur parasysh edhe gjendjen aktuale, kemi pasur informat se shkolla fillore në Novobërdë në fund të shkurtit të vitit të kaluar ka mbetur pa lëndë djegëse për këtë arsye e ka propozuar këtë pikë në rend dite. Fatkeqësishtë nuk kemi asnjë material as nga Drejtoria e Arsimit as nga zyrja e furnizimit, ndoshat nuk e kanë pregaditur materialin, ndoshta do ta pregadisnin deri në mbledhje të Kuvendit.

Kryesuesi e hapi diskutimin për këtë pikë.

Kryesuesi tha: nese nuk ka diskutime e kalojmë ne votim që këtë pikë ta dergojmë në Kuvend. Pasi nuk pat diskutime tjera kjo pikë u votua njëzëri me katër vota për nga antarët prezent të KPF-së që të shkoj në Kuvend.

Pika e tretë: Raport për ndarjen e subvencioneve në Drejtorin e Bujqësisë për vitin 2018-të; Kryesuesi tha: dhe për këtë pikë kemi kërkuar nga antarët e Kuvendit që të ipet një raport se ku janë ndarë këto subvencione nga Drejtoria e Bujqësisë për vitin 2018 për fermeret e Komunës, njejtë edhe në këtë pikë nuk kemi marrë asnjë material nga Drejtoria e Bujqësisë, shpresoj se do të mund ta marrim këtë material para fillimit të mbledhjes së Kuvendit të ardhshëm.

Kryesuesi e hapi diskutimin për këtë pikë.

Selatin Nuhiu tha: ne si KPF jemi duke punuar shumë keq pa bashkpunim me egzekutivin, ne këtu vetem po folmi kot. Egzekutivi shumë i papergjegjshëm në raport me Kuvendin dhe KPF-ën, sa kem ne informata këto subvencione janë ndar me grupe, me klane dhe nuk ka janë ndar drejt këto subvencione. Asnjëher nuk i kemi parë emrat e atyre personave të cilët kanë fituar subvencione.

Milica Jovanovic tha: pajtohem me kolegun, ka që një vit që Drejtor në Bujqësi nuk ka, edhe në mbledhjet e kaluara kemi kërkuar por askush nuk ka ardhur nuk ka raportuar andaj kërkoj që të raportohet.

Pasi nuk pat diskutime kjo pikë u votua njëzëri me katër vota për nga antarët prezent të shkoj në Kuvend.

Pika e katërt Të ndryshme.

Kryesuesi e hapi diskutimin për këtë pikë.

Selatin Nuhiu tha: te kjo pikë po diskutoj për boren që ka rën dje dhe nuk besoj që na ka befasuar pasi që është 17 dhjetori dhe në bazë të informatave që kam rrugët janë të mbyllura në zonat rurale në fshatr. Në fshatin Llabjan asgjë nuk funksionon, rrygët janë të mbyllura, ndriqimi nuk funksionon, kanalizimet janë të bllokuara, kjo është neglizhenc e egzekutivit. Që një vit nuk kam parë raport të auditorit, as të auditorit të brendshëm as të jashtëm, po perfundon ky vit dhe nuk kemi raport, nuk kemi raport të mirëfillt financiar vjetor.

Milica Jovanovic tha: sa i përket pastrimit të rrugëve kjo po ndodh çdo vit, kur fllon mu shkri bora këta e pastrojnë rrugën, po frigohem se edhe Kuvendin do ta kemi si Kuvendin e kaluar do ti kemi dy pika aprovimi i procesverbalit dhe të ndryshme.

Mirjana Simijonovic pasi përshendeti të pranishmit tha: sa më kujtohet në mbledhjen e kaluar të Kuvendit është propozuar asfaltimi i rrugës në fshatin Koretishtë.

Kryesuesi tha: ka qenë kërkesë që rruga egzistuese të kategorizohet në mënyr që mos të munden kamionët e mëdhenjë të kalojnë aty me pesha të rënda.

Mirjana Simijonovic tha: fatkeqësishtë i kemi shtatë gurthyes, dhe shpresoj që sa më shpejt të kategorizohet ajo rrugë dhe të asfaltohet përseri dhe më e keqja është se ata kamion levizin me një shpejtësi shumë të madhe.

Kryesuesi tha: sa i përket kësaj kërkesë që është dorzuar pak para se të filloj Kuvendi i kaluar, kam biseduar me znj.Shefkije Mehmeti dhe më ka njoftuar se e njehta kërkes ka shkuar edhe në Drejtori të Sherbimeve Publike dhe ka thënë se ajo Drejtori do të pregadis një vendim lidhur me kategorizimin e

këtyre rrugëve dhe ka thënë se ajo Drejtori do të mirret me këtë qështje, nuk e di se deri ku kanë arritur me këtë punë dhe asgjë nuk kanë sjell deri më tani.

Milica Jovanovic tha: ata gurthyes po vin po kërkojnë leje këtu, pastaj po ankohen po protestojn dhe këtë nuk po mundem ta kuptoj.

Mirjana Simijonovic tha: po e kuptoj se Ministria i jep këto leje por si është e mundur që në mesin e dy vendbanimeve të mëdha të jenë shtatë apo tetë gurthyes, mes Koretishtes dhe Strazhes rrugë është afër 2 km dhe gurthyesit po zgjerohen mes këtyre fshatrave, kam biseduar me njerzë që kanë pasur blet por tash as këto blet nuk i kanë më, e kuptoj se Ministria po ju lejon por a ka Komuna ndonjë rol, a mundën gurthyesit këtë veprimtari ta kryejn në vendbanime?.

Pasi nuk pati diskutime Kryesuesi i falemendëroi të pranishmit për pjesëmarrje.
Mbledhja përfundoi në orën 10:30

Procesëmbajtëse

Valmire Mustafa



Kryesues i Kuvendit

Nebojsa Arsic





Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova
Komuna e Novobërdës
Opština Novo Brdo - Municipality of Novo Brdo

KUVENDI KOMUNAL-SKUPSTINA OPSTINE- MUNICIPAL ASSEMBLY

DATË/A:	09.01.2019
PËR/ZA/TO:	Antarët e KPF-së
NGA/OD/FROM:	Nebojsa Arsic - Kryesues i Kuvendit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Propozimi i orarit të mbajtjes së mbledhjeve të KPF-së për vitin 2019

Të nderuar,

Në bazë të nenit 43.6 të Statutit po ju dërgoj orarin e mbajtjes së mbledhjeve të Komitetit për Politik dhe Financa për vitin 2019.

Nr	Dita	Data	Koha	Vendi
1.	E martë	22.01.2019	10:00	Salla e Kuvendit Komunal
2.	E martë	19.02.2019	10:00	Salla e Kuvendit Komunal
3.	E hënë	18.03.2019	10:00	Salla e Kuvendit Komunal
4.	E hënë	15.04.2019	10:00	Salla e Kuvendit Komunal
5.	E martë	21.05.2019	10:00	Salla e Kuvendit Komunal
6.	E martë	18.06.2019	10:00	Salla e Kuvendit Komunal
7.	E hënë	22.07.2019	10:00	Salla e Kuvendit Komunal
8.	E hënë	26.08.2019	10:00	Salla e Kuvendit Komunal
9.	E enjte	19.09.2019	10:00	Salla e Kuvendit Komunal
10.	E martë	22.10.2019	10:00	Salla e Kuvendit Komunal
11.	E hënë	18.11.2019	10:00	Salla e Kuvendit Komunal
12.	E hënë	16.12.2019	10:00	Salla e Kuvendit Komunal



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova
Komuna e Novobërdës
Opština Novo Brdo - Municipality of Novo Brdo

KUVENDI KOMUNAL-SKUPSTINA OPSTINE- MUNICIPAL ASSEMBLY

DATA/A:	09.01.2019
PËR/ZA/TO:	Antarët e Kuvendit Komunal
NGA/OD/FROM:	Nebojsa Arsic - Kryesues i Kuvendit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Propozimi i orarit të mbajtjes së mbledhjeve të Kuvendit Komunal për vitin 2019

Të nderuar,

Në bazë të nenit 43.6 të Statutit po ju dërgoj orarin e mbajtjes së mbledhjeve të Kuvendit të Komunës për vitin 2019.

Nr	Dita	Data	Koha	Vendi
1.	E enjte	31.01.2019	10:00	Salla e Kuvendit Komunal
2.	E enjte	28.02.2019	10:00	Salla e Kuvendit Komunal
3.	E enjte	28.03.2019	10:00	Salla e Kuvendit Komunal
4.	E enjte	25.04.2019	10:00	Salla e Kuvendit Komunal
5.	E enjte	30.05.2019	10:00	Salla e Kuvendit Komunal
6.	E enjte	27.06.2019	10:00	Salla e Kuvendit Komunal
7.	E mërkurë	31.07.2019	10:00	Salla e Kuvendit Komunal
8.	E enjte	05.09.2019	10:00	Salla e Kuvendit Komunal
9.	E hënë	30.09.2019	10:00	Salla e Kuvendit Komunal
10.	E enjte	31.10.2019	10:00	Salla e Kuvendit Komunal
11.	E mërkurë	27.11.2019	10:00	Salla e Kuvendit Komunal
12.	E enjte	26.12.2019	10:00	Salla e Kuvendit Komunal